



Greçia dhe marrëdhëniet Shqiptaro-Greke në median e shkruar shqiptare 2014

Sashenka Lleshaj
Dritan Sulçebe



Greqia dhe marrëdhëniet Shqiptaro-Greke në median e shkruar shqiptare 2014

Sashenka Lleshaj

Dritan Sulçebe



Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-te
Kutia Postare 1418
Tirane, Albania

Autorët: Sashenka Lleshaj
Dritan Sulçebe

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	5
Perceptimet e qytetarëve shqiptarë për Greqinë.....	6
Pse të monitorohet dhe të studiohet media?	7
2. Përmbledhja Ekzekutive.....	9
Çfarë është raportuar?	10
Si janë raportuar çështjet?	11
3. Metodologjia	14
Përzgjedhja e kampionit.....	14
Si përcaktohet konotacioni?	16
Përzgjedhja e rasteve studimore	17
4. Gjetjet kryesore dhe analiza	19
Tabloja e përgjithshme	19
Konotacioni: si janë raportuar çështjet	24
Rastet studimore	27
1. <i>Historia e lumtur</i> : Presidenca Greke e Këshillit të BE-së dhe vizitat dypalëshe të zyrtarëve të lartë grekë dhe shqiptarë.	28
2. <i>Historia e hidhur</i> : Rasti Kareli	34
3. <i>Historia e përzier</i> : Çështja e toponimeve	39
5. Referencat	43

Hyrje

Në dhjetor 2013, në konferencën “Duke debatuar marrëdhëniet e sotme shqiptaro-greke”, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare (AIIS) dhe Fondacioni Helen për Politikën e Jashtme dhe Europiane (ELIAMEP), të mbështetura nga Fondacioni Friedrich Ebert, prezantuan në Tiranë gjetjet e studimeve të tyre mbi perceptimet e shqiptarëve dhe grekëve për njëri-tjetrin, për marrëdhëniet midis dy shteteve si dhe rreth shumë dimensioneve të tjera sociale, politike dhe ekonomike të marrëdhënieve shqiptaro-greke.¹ Ndërkohë që perceptimet e dala nga studimet nuk ishin gjithmonë pozitive, media u nënvizua si një aktor/faktor i mundshëm për promovimin e stereotipeve në të dy anët e kufirit. Të bindur që nuk mund të veçojmë një shkak të caktuar dhe se ekzistojnë një seri faktorësh përgjegjës për mënyrën sesi njerëzit në këto vende fqinje e perceptojnë njëri-tjetrin, ky studim empirik mundohet të kryejë një analizë të thelluar në lidhje me këtë aktor të rëndësishëm që është *media*.

Në vazhdim të studimit të mësipërm, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare (AIIS) ka kryer një monitorim të medias së shkruar shqiptare për një periudhë 7 mujore, duke filluar nga *Janari 2014 deri në Korrik 2014*. Një studim i ngjashëm po zhvillohet edhe nga Fondacioni Helen për Politikën e Jashtme dhe Europiane (ELIAMEP) në Greqi. Më poshtë është studimi i kryer nga AIIS në shtypin e shkruar shqiptar dhe gjetjet kryesore në lidhje me mënyrën se si shtypi shqiptar përshkruan dimensionet e shumta të marrëdhënieve shqiptaro-greke. Edhe pse ky studim nuk pretendon të arrijë konkluzione të përgjithshme dhe përfaqësuese në lidhje me mënyrën si media shqiptare i portretizon këto marrëdhënie (duke pasur parasysh periudhën e shkurtër e monitorimit); ai megjithatë jep disa të dhëna të rëndësishme mbi tablonë e përgjithshme që media u ofron shqiptarëve (dhe

1. Studimet janë: Alba Çela dhe Sashenka Lleshaj, *Marrëdhëniet Shqipëri-Greqi në sytë e publikut shqiptar: Perceptime 2013*, Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung, Tirana, March 2014; Ioannis Armakolas, *The Greek Public Opinion towards Albania and the Albanians: Social attitudes and perceptions*, Hellenic Foundation for European and Foreign Policy and Friedrich Ebert Stiftung, December 2013.

jo vetëm shqiptarëve) në bazë ditore. Duke pasur parasysh kohën e limituar të studimit, dimensionin sasior i këtij studimi ofron të dhëna modeste, por në anën tjetër kjo është e kompensuar dhe në të njëjtën kohë e pasuruar nga analiza e thelluar e 3 çështjeve studimore me tema të rëndësishme të mbuluara nga shtypi shqiptar përgjatë periudhës së zgjedhur.

Perceptimet e qytetarëve shqiptarë për Greqinë

Studimi i mëparshëm për perceptimet *“Marrëdhëniet Shqipëri-Greqi në sytë e publikut shqiptar: Perceptime 2013”* raportoi një tablo të përzier të mënyrës se si shqiptarët e shohin Greqinë dhe grekët. Për sa u përket pyetjeve të lidhura me marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë, qeverisë greke dhe qeverisë shqiptare, si edhe marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe grekëve, rreth gjysma e të anketuarve i konsideron ato normale (45 përqind në rastin e parë, 52 përqind në rastin e dytë dhe 41 përqind në rastin e tretë). Në një plan krahasues, megjithëse përgjithësisht e konsideruar si normale, marrëdhënia midis shqiptarëve dhe grekëve është perceptuar si më pak pozitive në krahasim me marrëdhëniet Shqipëri-Greqi në nivel qeveritar.

Ndërkohë që thellohem në çështje specifike, tabloja duket më e komplikuar se sa marrëdhënia ‘normale’ e perceptuar në terma të përgjithshëm. Sipas studimit, qytetarët shqiptarë mendojnë se ka disa çështje të rëndësishme për t’u zgjidhur në mënyrë që marrëdhëniet midis dy vendeve të përmirësohen, si për shembull: çështja e kufirit, me 46 përqind të të anketuarve që e rendisin atë si prioritet të parë; e ndjekur nga çështja çame, me 77 përqind të të anketuarve që e rendisin atë në tre prioritetet kryesore; dhe në fund *trajtimi i emigrantëve shqiptarë në Greqi*, me 68 përqind të të anketuarve që e vendosin atë në tre prioritetet kryesore. Për më tepër, ndërkohë që më shumë se gjysma e të anketuarve u përgjigj se “Greqia e ka ndihmuar Shqipërinë në 20 vitet e fundit”, e njëjta masë u përgjigjën që “Greqia është akoma në gjendje lufte me Shqipërinë” dhe që “Greqia ndërhyr në punët e brendshme të Shqipërisë përmes minoritetit grek”, si dhe rreth 80 përqind mendojnë që “dështimi në zgjidhjen e çështjes çame është një pengesë e madhe për përmirësimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë”. Për më tepër, shumica e të anketuarve u përgjigjën se ata ose nuk pajtohen

ose nuk kanë informacion në lidhje me deklaratat se “Shqipëria dhe Greqia kanë nënshkruar një marrëveshje miqësie”, “qytetarët grekë e mbështesin anëtarësimin e Shqipërisë në BE” dhe se “qeveria greke e ka mbështetur procesin e integritetit të Shqipërisë në BE”. Së fundi, edhe pse 46 përqind e të anketuarve mendonin se asnjë vend nuk përbënte një kërcënim për Shqipërinë, 19 përqind janë përgjigjur se Greqia ishte një *kërcënim* për vendin.

Pa ndonjë ambicie për të pasur një fuqi shpjeguese, sondazhi i 2013-ës gjithsesi mundohet të eksplorojë mënyrën sesi perceptimet e mësipërme janë formësuar ose janë ndikuar duke i pyetur njerëzit për kontaktet e tyre personale apo familjare me Greqinë dhe grekët përmes udhëtimeve apo përvojave të qëndrimit në Greqi. Shumica e të anketuarve (57 përqind) ka qenë në Greqi për vizitë/qëndrim afatgjatë ose afatshkurtër, 74 përqind raportojnë se kanë punuar ose jetuar atje për më pak se 2 vjet dhe 45 përqind e tyre raportojnë se të paktën një prej familjarëve të tyre ka jetuar në Greqi. Çfarë është më e rëndësishme, vetëm 6 përqind e atyre që kanë jetuar në Greqi për më shumë se 2 vjet i përshkruajnë marrëdhëniet e tyre me grekët si të këqija ose shumë të këqija. Kështu, edhe pse përvoja personale me Greqinë dhe grekët mund të jetë përgjegjëse për perceptimet e shtetasve shqiptarë për vendin fqinj, duket se ky variabël është vetëm pjesërisht për t’u marrë parasysh meqenëse është e vështirë të shpjegohen tërësisht pikëpamjet negative ose stereotipet që ekzistojnë mbi Greqinë dhe grekët në një kohën kur qytetarët shqiptarë raportuan se eksperiencat personale në Greqi ishin kryesisht pozitive.

Pse të monitorohet dhe të studiohet media?

Ndërkohë që studimi i mësipërm mbi perceptimet ishte i dobishëm për *mbledhjen* dhe raportimin e pikëpamjeve të qytetarëve, ky studim mundohet të gërmojë mbi mënyrën sesi formohen pikëpamjet e qytetarëve. Duke qenë se është e vështirë të veçosh një faktor të vetëm përgjegjës për pikëpamjet dhe perceptimet e qytetarëve — siç u tha edhe më lart, eksperiencia personale mund të ketë një fuqi shpjeguese të limituar — është e dobishme të hulumtohet në lidhje me një formësues të gjithpranuar të opinionit publik,

siç është media.

Kjo vëmendje e veçantë që studimi i kushton medias vjen si rezultat i ndikimit të fortë që ka media në formësimin e perceptimeve, opinionëve dhe pikëpamjeve të njerëzve mbi shumë çështje. Është diskutuar për shumë kohë — tashmë edhe është pranuar si aksiomë në literaturën e komunikimit — që “media është mesazhi”.² Kështu, mesazhi nuk është i pavarur nga mjeti që e transmeton atë. Më e rëndësishmja, mënyra sesi perceptohet mesazhi përcaktohet po aq nga forma, konotacioni dhe mënyra e transmetimit të mesazhit sa edhe nga faktet që përcjell. Rrjedhimisht, roli i rëndësishëm i medias në formimin e opinionit publik e bën atë një objekt analize të rëndësishëm. Nga ky këndvështrim, studimi eksploron se si perceptimet e qytetarëve ndikohen nga media përmes studimit të mënyrës se si lajmet, opinionet dhe reportazhet shqiptare portretizojnë Greqinë, grekët dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke.

Ndërsa sot njerëzit janë gjithnjë e më shumë duke u informuar përmes mediave online dhe atyre sociale, në Shqipëri shtypi i shkruar është akoma gjerësisht i përdorur, edhe pse popullariteti është në rënie. Megjithatë, përveç Tirana Times, faja online e së cilës është e aksesueshme vetëm me abonim, gazetat e përgjegjedhura shqiptare në përgjithësi i publikojnë artikujt e shtypur edhe në faqet e tyre online, duke arritur kështu një audiencë më të gjerë.

2. Marshall McLuhan, *Understanding Media: The extensions of Man*, Routledge, London, 1964

Përmbledhja Ekzekutive

Periodha janar-korrik 2015 ishte shumë interesante për marrëdhëniet shqiptaro-greke për shkak të faktit se brenda një periudhe të shkurtër prej shtatë muajsh një shumëllojshmëri eventesh u shpalos, duke dërguar sinjale të ndryshme në marrëdhëniet dypalëshe. Këto shtatë muaj monitorimi të shtypit të shkruar shqiptar treguan se Greqia dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke janë të mbuluara vazhdimisht në shtypin shqiptar: nga Presidenca Greke e Këshillit të BE-së tek dhënia e statusit të vendit kandidatit të BE-së për Shqipërinë; nga zgjidhja e problemeve të toponimeve të vendlindjeve në pasaportat shqiptare të shqiptarëve të lindur në Greqi tek vrasja e një të dënuari shqiptar në burgjet greke; nga vizitat dypalëshe të nivelit të lartë tek reforma administrative në Shqipëri dhe pretendimet e minoritetit grek. Shtirja dhe intensiteti i mbulimit varet gjerësisht nga tema, karakteri i saj, rëndësia e saj për marrëdhëniet shqiptaro-greke, efekti që mund të shkaktojë në opinionin publik, potenciali i një situatë të caktuar për t'u përshkallëzuar më tej, si dhe nga momentum i një situatë ose ngjarjeje të caktuar në një nga vendet ose në të dyja.

Ky studim u përpoq t'u përgjigjej dy pyetjeve kryesore në lidhje me artikujt e publikuar nga shtypi i shkruar shqiptar: "*cilat* janë çështjet kryesore të mbuluara nga shtypi i shkruar shqiptar gjatë kësaj periudhe shtatë mujore në lidhje me Greqinë dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke?" dhe "*si* i mbuloi shtypi i shkruar shqiptar këto çështje?". Këto pyetje "*çfarë*" dhe "*si*" ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të mënyrës se si Greqia dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke janë portretizuar në mediat shqiptare sëbashku me temat kryesore që shoqërojnë dhe përkufizojnë këtë portretizim. Studimi tregon se pavarësisht nga fakti që mbulimi i çështjeve që lidhen me Greqinë dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke është përgjithësisht *i varur nga situata*, ka një *vazhdimësi* të disa temave kryesore në qasjen e përgjithshme që shtypi ka ndaj Greqisë dhe marrëdhënieve shqiptaro-greke, qasje kjo që është në rastin më të keq negative dhe mosbesuese dhe në rastin më të mirë shpresuese për përmirësime dhe një fillim të ri.

Çfarë është raportuar?

Ky studim analizoi një kampion prej 225 artikujsh nga tre gazeta të përditshme shqiptare të publikuara në shqip – Shqip, Panorama dhe Mapo – dhe një gazetë javore që botohet në anglisht – Tirana Times. Studimi tregon se shtypi shqiptar është shumë i ndjeshëm ndaj lajmeve të lidhura me marrëdhëniet shqiptaro-greke, duke marrë parasysh faktin që nga kampioni që analizuam 213 artikujt janë publikuar në tri gazetat e përditshme në 7 muaj, që do të thotë mesatarisht 10 artikuj në muaj/secila. Natyrisht, intensiteti nuk ishte i njëtrajtshëm duke ndryshuar në varësi të çështjeve specifike ‘të nxehta’ të momentit të cilat tërhiqnin vëmendjen e opinionit publik më së shumti. Kështu, janari, prilli dhe qershori kishin një nivel relativisht të lartë artikujsh mbi çështje që lidhen me marrëdhëniet shqiptaro-greke, me prillin që ishte në krye të listës me 61 artikuj në total.

Majat e raportimeve në janar, prill dhe qershor kishin të bënin me tre çështje në veçanti: (1) Presidenca Greke e Këshillit të BE-së dhe vizitat dypalëshe të nivelit të lartë midis Shqipërisë dhe Greqisë; (2) çështja Kareli: vrasjen e një të burgosuri shqiptar në një burg grek; dhe (3) një përzierje e çështjeve, por që lidhej kryesisht me mbulimin e reformës administrative në Shqipëri dhe efektet anësore që kjo mund të ketë për minoritetin grek në Shqipëri. Çështje të tjera të mbuluara në një mënyrë më të ekuilibruar gjatë gjithë kësaj periudhe shtatë mujore ishin: çështja e toponimeve të vendlindjeve në pasaportat shqiptare të shqiptarëve të lindur në Greqi, çështja çame dhe çështje të lidhura me Kishën Ortodokse Shqiptare.

Për më tepër, nga kampioni që analizuam duket që media shqiptare mbulon gjerësisht çështjet politike dhe socio-politike – përkatësisht me 62 përqind dhe 30 përqind të kampionit – të cilat gjithashtu dëshmojnë për një gjueti për *tregime të bujshme* që mund të prodhojnë tituj kryesorë dhe kështu të provokojnë reagim në opinionin publik shqiptar. Çështjet kulturore apo ekonomike në anën tjetër duken të lëna pas dore pasi përfaqësojnë vetëm 4 për qind të kampionit të analizuar.

Si janë raportuar çështjet?

Duke përdorur një analizë të thjeshtë përmbajtjeje me një theks të veçantë në konotacion ky studim i ndan artikujt në katër kategori kryesore: artikuj me konotacion pozitiv, konotacion neutral, konotacion quasi-negativ dhe artikuj me konotacion negativ. Studimi gjeti se gjatë këtyre shtatë muajve rezultatet ishin të përziera edhe pse *artikujt me konotacion negativ* ishin grupi më i madh me 35 përqind të kampionit. Artikujt me konotacion neutral përfaqësonin 28 përqind të kampionit ndërsa artikujt quasi-negativë dhe artikujt pozitivë përbënin përkatësisht 24 përqind dhe 13 përqind të kampionit.

Pavarësisht tablosë së mësipërme ‘negative’, studimi tregoi se raportimi në median shqiptare *varej nga situata*, sipas rastit specifik në shqyrtim, dhe ai ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme nga rasti në rast. Kështu, kjo periudhë e pa shtypin shqiptar të lëvizë nga histori të ‘lumtura’ në ato të ‘hidhura’ në një periudhë shumë të shkurtër siç ishte rasti i mbuluar me shumë pozitivitet i Presidencës Greke të Këshillit të BE-së dhe vizitave dypalëshe në janar dhe shkurt (me 47 përqind të artikujve që kanë një konotacion pozitiv) deri tek rasti Kareli i mbuluar shumë negativisht (me 68 përqind të artikujve që kanë një konotacion negativ) në mars dhe prill. Në mes të këtyre historive dhe përgjatë gjithë periudhës në shqyrtim, histori të tjera u mbuluan kryesisht përmes një konotacioni neutral, siç ishte rasti i toponimeve të vendlindjeve në pasaportat shqiptare të shqiptarëve të lindur në Greqi (45 përqind e artikujve kishte një konotacion neutral).

Kështu, duke pasur parasysh tablonë e mësipërme dhe sidomos mënyrën e zëshme përmes së cilës u mbulua rasti Kareli në median shqiptare, studimi gjithashtu konsideroi shtrembërimin e përgjithshëm të të dhënave për shkak të një rasti të pazakontë që nuk është përfaqësues i marrëdhënieve afatgjata shqiptaro-greke. Prandaj, në qoftë se të dhënat do të ishin analizuar pa rastin Kareli, tabloja do të ishte në mënyrë të konsiderueshme neutrale, me artikujt me konotacion neutral që përfaqësojnë pjesën më të madhe me 35 përqind të kampionit.

Edhe pse raportimi në median shqiptare ndryshoi në varësi të situatës dhe të rastit në shqyrtim, ka pasur disa *tema kryesore* përgjatë kampionit të

cilat mund të vërehen pavarësisht rastit, veçanërisht kur artikujt kanë një konotacion negativ. Këto ishin:

- (1) *Marrëdhëniet me Greqinë duhet të trajtohen me kujdes pasi këtij vendi nuk mund t'i zihet besë plotësisht.* Kjo temë ka qenë e pranishme gjatë gjithë studimit në të tre rastet studimore që janë analizuar, veçanërisht në kategoritë me konotacion negativ të secilit rast. Në rastin e Presidencës Greke të Këshillit të BE-së, vizitat dypalëshe dhe statusin kandidat për në BE të Shqipërisë, mesazhi ishte: Greqia është një aktor racional, duke synuar interesin e vet dhe me siguri do të kërkojë diçka në këmbim për mbështetjen e saj aktuale për Shqipërinë dhe lidhjet më të ngushta me Shqipërinë. Këta artikuj kryesisht po balanconin ato më entuziastët mbi këtë temë. Në rastin e Karelit dhe toponimeve, mesazhi ishte: e njëjtë Greqi e vjetër që nuk mund t'i zihet besë kur bëhet fjalë për çështjet më të ndjeshme me Shqipërinë dhe shqiptarët.
- (2) *Greqia i keqtrajton emigrantët shqiptarë në shumë nivele.* Kjo kategori artikujsh ishte e pranishme si në rastin Kareli ashtu dhe në rastin e toponimeve dhe e portretizoi Greqinë si një shkelëse sistematike të emigrantëve shqiptarë, që i torturon ata, i ndalon ata të shohin familjet e tyre, i ndalon ata për të hyrë në Greqi, ua bën jetën të vështirë edhe kur ata kanë lindur dhe kanë jetuar në Greqi gjithë jetën e tyre, i shkel të drejtat e tyre themelore, etj. Kjo kategori artikujsh shpesh shoqërohej nga një viktimizim kombëtar kolektiv i Shqipërisë dhe shqiptarëve kundrejt Greqisë. Këta artikuj synonin gjithashtu të provokonin një efekt emocional tek lexuesit.
- (3) *Ka një potencial në marrëdhëniet shqiptaro-greke për një partneritet afatgjatë.* Kjo temë ishte e pranishme në artikujt me konotacion pozitiv kur raportohej mbi vizitat dypalëshe dhe finalizimin e marrëveshjes që zgjidhi çështjen e toponimeve. Këta artikuj u janë referuar gjerësisht risive të këtyre zhvillimeve me terma të tillë si: 'fillim i ri', 'kapitull i ri', 'partneritet i ri'.
- (4) *Shqipëria dhe Greqia mund t'i zgjidhin çështjet, por ato janë larg nga një "marrëdhënie romantike".* Kjo temë ishte kryesisht e pranishme në

artikujt me konotacion neutral dhe synonte balancimin e entuziazmit për zhvillime të reja pozitive në marrëdhëniet shqiptaro-greke me çështjet që janë ende për t'u diskutuar dhe për t'u zgjidhur mes dy vendeve. Kjo temë ishte veçanërisht e pranishme në rastin e vizitave dypalëshe dhe mbështetjes së Greqisë për statusin e vendit kandidat të Shqipërisë në BE si edhe në mbulimin e zgjidhjes së çështjes së toponimeve në maj.

Për të përfunduar, siç dhe do të tregohet në vazhdim, ka disa tema kryesore të qëndrueshme në diskursin mediatik shqiptar, megjithëse theksi ndryshon në varësi të situatës në shqyrtim dhe 'urgjencës' së ngjarjeve.

Metodologjia

Metoda kryesore e kërkimit në këtë studim është *analiza e përmbajtjes* që do të konsistojë në monitorimin sasior dhe cilësor të medias. Përmbajtja që do të analizohen përbëhet nga artikuj nga shtypit i shkruar shqiptar (një analizë e ngjashme është përdorur nga ELIAMEP për të kryer hulumtim mbi mediat greke). Kjo metodologji është përdorur zakonisht për aktivitete të monitorimit të medias, veçanërisht gjatë zgjedhjeve dhe sigurisht në akademi për analizë të ligjërimit. AIIS e ka përdorur këtë metodologji në një projekt dhe publikim të mëparshëm: *“Shqipëria dhe Serbia: A përputhen perceptimet me realitetin?”*³

Përzgjedhja e kampionit

Ky studim monitoroi tre gazeta të përditshme shqiptare – gazetat *Shqip*, *Mapo* dhe *Panorama* – dhe një gazetë javore që botohet në anglisht – *Tirana Times*. Kjo përzgjedhje është bërë *a priori* në përputhje me numrin e kopjeve të shitura për çdo media shqiptare ndërsa *Tirana Times* është zgjedhur për shkak të audiencës specifike anglishtfolëse në Tiranë, kryesisht të përbërë nga misionet e huaja diplomatike dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare në Tiranë, përveç lexuesve të saj shqiptarë.

Pas kësaj përzgjedhje fillestare, këto media janë monitoruar për një periudhë prej *shtatë muajsh*, duke filluar nga janari 2014 deri në korrik 2014. Këto 7 muaj janë përzgjedhur për shkak të çështjeve shumë të spikatura që u vunë re në marrëdhëniet shqiptaro-greke gjatë kësaj kohe: Presidenca Greke e Këshillit të BE-së, negociatat intensive të zyrtarëve shqiptarë në mënyrë që Shqipërisë t’i jepej statusi i vendit kandidat në Bashkimin Europian, vizitat e shumta dypalëshe të zyrtarëve të lartë shqiptarë dhe grekë në të dy vendet, vrasja e një të burgosuri shqiptar në Greqi pas torturave, zgjidhja e çështjes së gjuhës së emrave të vende greke në pasaportat shqiptare të shqiptarëve

3. Andi Balla, Filip Ejdos & Megi Llubani, *Shqipëria dhe Serbia: A përputhen perceptimet me realitetin?*, Albanian Institute for International Studies and Belgrade Centre for Security Policy, Tirana and Belgrade, 2013.

të lindur në Greqi – e ashtuquajtura çështja e toponimeve – si dhe çështja e minoritetit grek dhe reformës administrative në Shqipëri, sa për të përmendur çështjet më të rëndësishme. Kjo amalgamë çështjesh e bën këtë periudhë shtatë mujore me interes të lartë për të eksploruar mënyrat se si këto çështje janë raportuar në mediat shqiptare.

Në mënyrë që të mblidhej një kampion përfaqësues i artikujve, ne paracaktuam një seri *fjalësh kyçe*, disa nga të cilat ishin të diskutuar më parë në anketën 2013, të tilla si: kufijtë detarë, emigrantëve shqiptarë në Greqi, çështja çame, Kisha Ortodokse e Shqipërisë, minoriteti grek në Shqipëri, varrezat e ushtarëve grekë, pensionet greke në Shqipëri dhe Ligji i Luftës. Përveç këtyre, në mënyrë që të arrihej mbledhja e sa më shumë artikuj të ishte e mundur në lidhje me Shqipërinë dhe Greqinë, si dhe për të përshtatur hulumtimin tonë për periudhën 7 mujore që po mbulohej, u shtuan disa fjalë kyçe të tjera, si: Greqia, marrëdhëniet shqiptaro-greke, Janullatos, Venizelos, Papulias/Papulias, Omonia, PBDNJ, PDIU, (të) burgosurit shqiptarë në Greqi, Ilia Kareli/Kudret Kume, Presidenca Greke e Këshillit të BE-së dhe çështja e toponimeve. Nëpërmjet këtyre fjalëve kyçe,⁴ një kërkim i kompjuterizuar i verbër u krye mbi një bazë të madhe të dhënash me artikuj gazetash të skanuara. Duke pasur parasysh numrin e madh të fjalëve kyçe të përdorura dhe saktësinë e metodës së aplikuar në përzgjedhjen e artikujve, ne besojmë se kampioni është përfaqësues i popullatës më të gjerë të artikujve që mbulojnë dimensionet e ndryshme të marrëdhënieve shqiptaro-greke.

Ky kërkim rezultoi në 480 artikuj nga të cilët **225 ishin artikujt relevant**. Ky përgjysmim i numrit të artikujve ndodhi për tri arsye: (1) një pjesë e konsiderueshme e artikujve ishin të *mbivendosur* në fjalë kyçe të ndryshme, për shembull ata artikuj që u shfaqën për kërkimin Venizelos, gjithashtu u shfaqën edhe për fjalën kyçe Presidenca Greke e BE/KE dhe Greqia duke qenë se në artikull ishin të pranishme më shumë se një fjalë kyçe; (2) kërkimi i verbër nuk e bënte dot dallimin midis një artikulli gazete në faqen e parë dhe *duplikimit* të tij në brendësi të gazetës dhe për pasojë e numëronte artikullin

4. Kërkimi është bërë me fjalë kyçe në gjuhën shqipe në rastin e Shqip, Mapo dhe Panorama dhe në anglisht në rastin e Tirana Times. Fjalët janë përshtatur gramatikisht gjatë kërkimit, në mënyrë që të shfaqeshin forma të ndryshme gramatikore të fjalëve. Në rastin e fjalëve shqipe, është përdorur rrënja e fjalës në mënyrë që të mbulohej ndryshimi i mbaresave të rasave të ndryshme.

dy herë në qoftë se një fjalë specifike gjendej në titullin e saj – duke e bërë kështu artikullin të shfaqej në faqen e parë dhe në brendësi në të njëjtën kohë; (3) një pjesë e artikujve nuk ishin *relevant* për këtë hulumtim dhe kjo ndodhi kryesisht me ata artikuj që i referoheshin politikës së brendshme partiake të Shqipërisë, siç ishte rasti me negociatat e PDIU me partitë e tjera ose me qeverinë në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk ka pasur asnjë referencë në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-grek, minoritetin grek në Shqipëri, çështja çame, apo ndonjë çështje tjetër që do të ishte e rëndësishë primare apo sekondare për këtë studim.

Si përcaktohet konotacioni?

Një pjesë qendrore e këtij studimi është analiza e përmbajtjes e cila është kryer përmes një analize të hollësishme të *konotacionit në çdo artikull*, të temave kryesore si dhe të diskursit të përdorur. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përcaktimit të konotacionit dhe mënyrës se si transmetohet informacioni. Studimi fillimisht paracaktoi tre kategori kryesore për të përcaktuar konotacionin: *negativ, pozitiv dhe neutral*, por kur analiza e përmbajtjes së artikujve filloi, ishte e qartë se një kategori e katërt ishte e nevojshme për ta bërë analizën më të saktë: artikujt me konotacion *quasi-negativ*.

Metoda e përdorur për të përcaktuar konotacionin e artikujve ishte në përputhje me gjuhën, tonin dhe përdorimin e fjalëve specifike. Kjo ishte një pjesë sa e veçantë aq dhe e vështirë e metodologjisë duke qenë se duheshin vendosur disa standarde në mënyrë që përcaktimi i konotacionit të ishte konsistent dhe të linte sa më pak hapësirë që të ishte e mundur për interpretime kontradiktore përgjatë studimit. Kategorizimi është bërë në këtë mënyrë:

- Një artikull është klasifikuar se ka *konotacion negativ* kur: (1) janë përdorur fjalë të tilla si konflikt, kundërshtim, problem/atic, mosbesim, keqtrajtim, mospërputhje, pazgjidhur, etj; (2) ka pasur një shprehje të dukshme të opinionit, pozicionit apo pikëpamjeve të reporterit/autorit të artikullit dhe toni ka theksuar një aspekt negativ të një situate; (3) ka pasur foto, kutiza apo nënvizime specifike që ndikojnë në formësimin e një imazhi të përgjithshëm negativ nga impakti i parë i lexuesve me artikullin.

- Një artikull është përcaktuar si *quasi-negativ* kur kushti i parë i fjalëve dhe gjuhës së përdorur është i pranishëm, por nga fjalët është e vështirë të vërehet qëndrimi i autorit lidhur me këtë çështje dhe raportimi në terma të përgjithshme është neutral – me shumë citime dhe pak perifrazim ose fjali që shprehin qëndrimin. Megjithatë, kjo kategori nuk mund të klasifikohet si neutrale për shkak të tonit negativ që e shoqëron atë dhe përzgjedhjen specifike nga autori/redaktori i temës dhe citate të njëanshme, duke përfshirë edhe hapësirën fizike që i është dhënë artikullit në gazetë.⁵
- Një artikull është përcaktuar si *neutral* kur është përdorur një gjuhë e moderuar, ka citime nga të dy anët e çështjes dhe raportimi nuk ka ton të flakët për asnjërën anë. Në të njëjtën kohë, fotot e përdorura dhe hapësira e dhënë është e moderuar dhe nuk e lë lexuesin me ndonjë përshtypje të veçantë negative apo pozitive.
- Një artikull është përcaktuar si *pozitiv*, kur: (1) janë përdorur fjalë të tilla si: bashkëpunimi, marrëveshje, partneriteti, zgjidhje, miqësi, përmirësim, mbështetje, etj; (2) ka pasur një mendim, pozicionim ose pikëpamje të dukshme të shprehur nga reporteri/autori i artikullit si dhe një theksim të aspekteve pozitive të një situatë; (3) ka pasur fotografi të veçanta, kutiza apo nënvizime specifike që ndikojnë në formësimin e një imazhi të përgjithshëm pozitiv nga impakti i parë i lexuesve me artikullin.

Edhe pse këto standarde e bëjnë klasifikimin sistematik deri në një shkallë të caktuar, është e pamundur në këtë rast për të objektivizuar krejtësisht gjykimin e hulumtuesit në lidhje me konotacionin e një artikulli të veçantë.

Përzgjedhja e rasteve studimore

Ky studim ka vlerësuar se monitorimi i medias nuk do të ishte i plotë vetëm me të dhënat sasiore mbi temat e trajtuara dhe konotacionin që i shoqëron ato, dhe kështu një analizë e thelluar e disa rasteve studimore është e nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve që të dhënat statistikore zakonisht

5. Quasi-pozitiv do të ishte kategoria simetrike, por kemi vlerësuar se nuk kishte nevojë për një kategori të tillë nga fakti se ata artikuj që raportojnë fakte pozitive raportojnë zëshëm mbi aspektet pozitive të situatës duke i bërë artikujt me raportim neutral pozitivë statistikisht të parëndësishëm.


lënë pa përgjigje. Kështu, tre raste studimore janë përzgjedhur që mbulojnë si aspektet pozitive ashtu dhe ato negative të marrëdhënieve Shqipëri-Greqi, ngjarje këto relevante për periudhën janar-korrik 2014 (por jo e kufizuar vetëm në këtë afat kohor).

Gjetjet kryesore dhe analiza

Si raportojnë mediat mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke dhe si portretizohen këto marrëdhënie? Duke u përpjekur t'i përgjigjet pyetjes së mësipërme, ky kapitull ofron analizën thelbësore të studimit në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë ofron informacionin e përgjithshëm sasior mbi natyrën e artikujve dhe shtrirjen e tyre si edhe mbi mbulimin e çështjeve dhe gjetjet në lidhje me konotacionin. Pjesa e dytë fokusohet në analizat e thelluara të tre rasteve studimore: (1) Vizitat dypalëshe të zyrtarëve të lartë grekë dhe shqiptarë në vendin fqinj; (2) Rasti Kareli: një i burgosur shqiptar vdes pas torturave nga rojet e burgut; (3) Zgjidhja e çështjes së toponimeve të vendlindjeve në pasaportat shqiptare të shqiptarëve të lindur në Greqi.


Tabloja e përgjithshme

Për 225 artikujt, *shtrirja sipas gazetave* është si vijon: pjesa më e madhe është nga Shqip me 88 artikuj, e ndjekur nga Mapo me 66 artikuj dhe Panorama e Tirana Times me përkatësisht 59 dhe 12 artikuj secila. Për arsye të kuptueshme, vëllimi i artikujve nga gazetat e përditshme shqiptare është shumë më i lartë se vëllimi i artikujve nga gazeta e përjavshme në anglisht, Tirana Times.



Grafiku 1

Për më tepër, artikujt janë klasifikuar sipas *fokusit* të tyre në mënyrë që të përcaktohej nëse marrëdhëniet shqiptaro-greke (apo ndonjë aspekt i këtyre marrëdhënieve) dhe/ose Greqia ishin fokusi qendror i artikujve të kampionit të këtij studimit ose jo. Nga grafiku 2 më poshtë është e dukshme se 85 përqind e kampionit u përqendrua në marrëdhëniet shqiptaro-greke apo ndonjë çështje që lidhet drejtpërdrejt me këto marrëdhënie dhe 15 përqind u fokusuan në çështjet e brendshme të të dy vendeve të cilat mund të kenë një ndikim indirekt mbi vendet fqinje ose në marrëdhëniet shqiptaro-greke. Duhet të theksohet se shumica e këtyre artikujve që nuk ka pasur një fokus të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet shqiptaro-greke, por që mund të ndikojë marrëdhëniet dypalëshe ishin ato artikuj që lidhen me reformën administrative në Shqipëri dhe minoritetit grek. Në shumë raste këto artikuj shkurtimisht adresuan minoritetit grek dhe shqetësimet e këtij komuniteti me reformën administrative, por fokusi i artikujve ishte i ndryshëm. Ndërsa këta artikuj ishin të vlefshëm për këtë hulumtim, studimi duhet gjithsesi t'i raportoje ato si një kategori e caktuar artikujsh.




Grafiku 2

Përpos këtij kategorizimi sipas gazetave dhe kategorizimi sipas fokusit, artikujt u grupuan gjithashtu në përputhje me çështjet kryesore që ato mbuluan. Kështu, gjashtë kategoritë kryesore të monitoruara të çështjeve të mbuluara gjatë shtatë muajve studim janë: çështja Kareli; Presidenca Greke e Këshillit të BE-së dhe vizitave dypalëshe të nivelit të lartë; reforma administrative në Shqipëri dhe minoritetin grek; çështja e toponimeve; çështja çame; si dhe

Kisha Ortodokse Shqiptare. Siç duket nga grafiku 3, mbulimi i çështjes Ilia Kareli ishte mbizotërues në krahasim me pjesën tjetër të çështjeve me 66 artikuj. Kjo u pasua nga 45 artikuj mbi Presidencës Greke të Këshillit të BE-së dhe vizitave dypalëshe të nivelit të lartë dhe 44 artikuj mbi reformën administrative në Shqipëri dhe minoritetin grek. Mbulimi i këtyre tri çështjeve përbënte pothuajse 70 përqind të kampionit.⁶ Çështja e toponimeve, çështja çame dhe Kisha Ortodokse Shqiptare u mbuluan përkatësisht nga 29 artikuj, 21 artikuj dhe 9 artikuj. Çështjet e tjera, nga ato ekonomike deri të çështjet historike të origjinës së gjuhës, janë mbuluar nga 14 artikuj gjithsej.⁷

Siç u tha në hyrje të kapitullit, tre nga këto raste do të analizohen në detaj në seksionin përfundimtar në mënyrë që të zhvillohet një analizë më e thelluar mbi mënyrën si çështje të caktuara janë raportuar në media.




Grafiku 3

6. Duhet të theksohet se artikujt mbi reformën administrative në Shqipëri dhe minoritetin grek nuk kanë qenë gjithmonë të lidhura drejtpërdrejt me çështjet greke-shqiptare apo minoritetin grek, edhe pse këta artikuj janë klasifikuar si të rëndësishme për studimin tonë sepse edhe pse në mënyrë dytësore ata sërish përmendin mënyrën si reforma do të ndikojnë minoritetin.

7. Duhet të theksohet se tre artikuj janë të mbivendosur në kategorinë e Presidencës Greke të Këshillit të BE-së dhe vizitave dypalëshe të nivelit të lartë me çështjen e toponimeve për shkak se artikujt mbulojnë të dyja çështjet. Ky është rasti me vizitën e Zëvendëskryeministrit grek dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Evangelos Venizelos në Tiranë dhe diskutimin e çështjes së toponimeve. Këta artikuj janë numëruar dy herë pasi u grupuan në të dyja kategoritë për shkak të analizës së mëtejshme në rastet studimore.


Kur është fjala për *shtrirjen mujore të artikujve*, edhe pse ekziston një majë e madhe në prill me 61 artikuj dhe dy maja më të vogla në janar dhe qershor, me 32 dhe 34 artikuj përkatësisht, nuk ka lëkundje ekstreme, që do të thotë se çështjet mbi Greqinë dhe/ose marrëdhëniet shqiptaro-greke janë një temë e vazhdueshme në median shqiptare, pavarësisht zhvillimeve të veçanta që vlejné për vëmendje më të madhe. Është interesante të studiohen majat e raportimit duke qenë se ato janë të lidhura me temat/çështjet kryesore të diskutuara më lart. Kështu, maja e prillit është rezultat i mbulimit të gjerë dhe intensiv të çështjes Kareli, ndërsa maja e janarit është e lidhur me Presidencën Greke të Këshillit të BE-së dhe vizitat dypalëshe të nivelit të lartë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Maja e tretë është më shumë një përzjerje e çështjeve, edhe pse ajo është e lidhur kryesisht me mbulimin e reformës administrative në Shqipëri.



Grafiku 4


Në këtë pikë është e rëndësishme të vihet re gjithashtu *shtrirja mujore e artikujve sipas gazetave*, në mënyrë që të shikohet nëse shtrirja e përgjithshme mujore e grafikut 4 është rezultat i mbulimit nga një gazetë specifike apo nëse ajo përfaqëson një trend të përgjithshëm, pavarësisht nga gazetatat e veçanta. Siç tregon qartë edhe grafiku 5, ekziston një koherencë interesante midis intensitetit të mbulimit të çështjeve në gazeta të ndryshme. Nëse grafiku i shtrirjes mujore të artikujve për çdo gazetë do të shihet veç e veç, atëherë do të vërehen të njëjtat maja janar-prill-qershor. Prandaj, majat e mbulimit të vërejtura në grafikun e

mëparshme janë një agregim i majave të të gjitha gazetave të veçanta në prill, janar dhe qershor. Kështu, është e qartë se temave “të nxehta” të një periudhe të caktuar i është kushtuar vëmendje e veçantë në të gjithë median shqiptare dhe jo vetëm nga botues specifikë. Megjithatë, është e vështirë për të gjetur shkaqet dhe efektet në këtë fazë, pasi popullariteti i mbulimit të çështjeve “të nxehta” që u përmend më lart me shumë gjasa ka kontribuar gjithashtu që këto çështjeve të bëhen “të nxehta”.



Grafiku 5

Së fundi, artikujt janë kategorizuar sipas *natyrës* së tyre në artikuj që kanë të bëjnë me çështje: politike, socio-politike, sociale, kulturore dhe ekonomike. Nga 225 artikuj, 62 përqind kanë të bëjnë me çështje politike, 30 përqind kanë të bëjnë me çështjet socio-politik dhe pjesa e mbetur prej 8 përqind janë artikuj që kanë të bëjnë me çështjet sociale, kulturore dhe ekonomike. Megjithëse fjalët kyçe të zgjedhura mund të jenë pjesërisht përgjegjëse për mbizotërimin e artikujve që merren me çështjet politike dhe socio-politike duke qenë se mund të vërehet një tendencë e qartë e shtypit shqiptar për të botuar artikuj të natyrës politike dhe socio-politik, që në rastin e këtij studimi përfaqësojnë 92 përqind të kampionit.




Grafiku 6

Konotacioni: si janë raportuar çështjet

Të përgjigjurit ndaj pyetjes sesi media shqiptare raporton dhe më tej portretizon Greqinë dhe/ose marrëdhëniet Shqipëri-Greqi kërkon zhvillimin e një analize përmbajtjeje të detajuar të artikujve të publikuar. Konotacioni është një instrument shumë interesant për të eksploruar mënyrën e mbulimit mediatik të çështjeve të ndryshme, sesi ato janë portretizuar, se çfarë është konstatuar dhe se çfarë është nënkuptuar nëpërmjet një titulli, teme apo rubrike informacioni të caktuar dhe së fundmi se cili është qëllimi i artikullit në vetvete, mesazhi kryesor që artikulli kërkon të përçojë dhe gjithashtu cilat janë reagimet logjike, emocionale që artikulli shkakton tek lexuesit. Në këtë mënyrë, përcaktimi i konotacionit është një sipërmarrje komplekse e të përgjigjurit njëkohësisht të shumë pyetjeve të tipit ‘*çfarë*’ dhe ‘*si*’.


Siç u shpjegua në kapitullin e mëparshëm mbi metodologjinë, duke u bazuar në gjuhën, tonin, fjalët e caktuara, si dhe në vizualizimin e artikullit dhe pohimet subjektive, artikujt janë kategorizuar në *katër grupe kryesore konotacioni*: pozitive, neutrale, quasi-negative dhe negative. Grafiku 7 pasqyron gjetjet nga klasifikimi i përgjithshëm i 225 artikujve në grupe konotacioni. Kështu, artikujt me konotacion negativ përbëjnë grupin më të madh me 35 përqind të kampionit, të ndjekur nga artikujt neutralë me 28 përqind, artikujt quasi-negativë me 24 përqind dhe ata pozitivë me 13 përqind. Nëse konsiderojmë artikujt negativë dhe quasi-negativë në njërën anë dhe ata pozitivë dhe

neutralë në anën tjetër, atëherë më shumë se gjysma e kampionit (59 përqind) janë artikuj me një konotacion negativ ose quasi-negativ.



Grafiku 7


Në qoftë se hedhim një vështrim në shpërndarjen e konotacionit sipas gazetave, në grafikun 8 mund të vërehet se për gazetën Panorama dhe Shqip artikujt me konotacion negativ zënë pjesën më të madhe me përkatësisht 42 dhe 38 përqind. Për më tepër, artikujt me konotacion negativ dhe quasi-negativ në këto gazeta përbëjnë më shumë se gjysmën e kampioneve përkatës në këto gazeta. Mapo ka një shpërndarje të barabartë të artikujve me konotacion negativ, quasi-negativ dhe neutral me nga 29 përqind për secilën nga këto kategori. Gjysma e artikujve të Tirana Times janë neutral dhe ¼-ta e kampionit nga kjo gazetë ka konotacion pozitiv. Mbulimi i moderuar i ngjarjeve nga gazeta Tirana Times mund të shpjegohet me audiencën specifike që kjo gazetë synon.



Grafiku 8

Të shtatë muajt e mbuluar nga ky studim ishin mjaft aktivë në drejtim të zhvillimeve të reja dhe të vazhdueshme në marrëdhëniet shqiptaro-greke, por në të njëjtën kohë është e vështirë për të përgjithësuar raportimin e shtypit të shkruar shqiptar mbi Greqinë dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke duke u fokusuar ekskluzivisht në këto shtatë muaj. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë kësaj periudhe kohore ndodhi një episod jo shumë i zakonshëm për të dy vendet: Rasti Kareli. Ky rast, siç do të diskutohet në detaje në seksionin tjetër, u pasqyrua gjerësisht në një mënyrë negative dhe gjysmë negative në të gjithë mediat shqiptare, duke shkaktuar kështu zhvendosjen në mënyrë domethënëse të të dhënave tona mbi konotacionin drejt anës negative të spektrit të konotacionit. Edhe pse kjo nuk është një zhvendosje artificiale — duke marrë parasysh faktin që ky është mbulimi mediatik real i ngjarjes — ky rast shënon një ngjarje të jashtëzakonshme që nuk është domosdoshmërisht përfaqësuese e tendencave të tjera të modaliteteve dhe konotacionit të mbulimit mediatik në Shqipëri.

Në mënyrë që të kemi një pamje më të qartë të mbulimit të zakonshëm të marrëdhënieve Shqipëri-Greqi ose të çështjeve të lidhura me to, si më poshtë është pasqyruar shpërndarja e konotacioneve pa marrë parasysh çështjen Kareli. Nga grafiku 9, është e qartë që çështja Kareli ka pasur një efekt të rëndësishëm në shpërndarjen e konotacioneve në kampionin e këtij studimi. Kështu, pasqyrimi më “normal” i mbulimit mediatik të shtypit shqiptar është ai *neutral*, megjithëse artikujt negativë ose quasi-negativë përbëjnë sërish 47 përqind të kampionit.



Grafiku 9

Rastet studimore

Pas krijimit të një ideje të përgjithshme mbi mbulimin mediatik shqiptare në lidhje me shumë çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet shqiptaro-greke gjatë një periudhe shtatë mujore, ky seksion do të japë disa të dhëna më shumë në lidhje mënyrën e raportimit të disa rasteve dhe do të analizojë temat specifike që kanë shoqëruar mbulimin e tyre. Rendi i analizimit të këtyre rasteve studimore do të jetë kronologjik, duke filluar nga Presidenca Greke e Këshillit të BE dhe vizitat e dypalëshe të zyrtarëve të lartë grekë dhe shqiptarë në të dy vendet në janar dhe shkurt, duke vazhduar më pas me rastin Kareli në fund të marsit dhe gjatë prillit, për të përfunduar me zgjidhjen e çështjes së toponimeve, e cila u diskutua gjatë gjithë periudhës shtatë mujore deri sa u zgjidh në maj.

Arsyeja pse këto tre raste janë zgjedhur që të analizohen më hollësisht, pavarësisht nga vëmendja e medias ndaj tyre, është edhe për shkak se përfaqësojnë tre dimensione të ndryshme të bashkëpunimit dhe konfliktit në marrëdhëniet shqiptaro-greke: historia *e lumtur*, historia *e hidhur* dhe historia *e përzier*. Kështu, analiza e thelluar do të shqyrtojë se si marrëdhëniet shqiptaro-greke dhe Greqia në veçanti janë portretizuar, nën prizmin e tre historive të ndryshme. A ka ndarje në varësi të rastit të “nxehtë” të momentit apo ka një vazhdimësi në imazhin që media transmeton për audiencën?

1. Historia e lumtur: Presidenca Greke e Këshillit të BE-së dhe vizitat e dypalëshe të zyrtarëve të lartë grekë dhe shqiptarë.

Ngjarja

Nga 1 janari deri më 30 qershor 2014 ishte radha e Greqisë për të mbajtur Presidencën e radhës së Këshillit të Bashkimit Europian. Fillimi i Presidencës Greke të Këshillit të BE-së u prit me entuziazëm nga ana e zyrtarëve shqiptarë të cilët shpresonin që Greqia do të ishte një avokat aktiv i dhënies së statusit të vendit kandidat në BE për Shqipërisë. Para Presidencës Greke, në dhjetor 2013, Këshilli i BE-së e kishte shtyrë për në fund të qershorit vendimin për dhënien e statusit të vendit kandidat Shqipërisë, pas kërkesave nga Mbretëria e Bashkuar, Vendet e Ulëta, Gjermania, Franca, Republika Çeke dhe Spanja, që kërkonin të shihnin progres të mëtijshëm të Shqipërisë në kryerjen e disa reformave.

Fillimi i janarit 2014 i gjeti zyrtarët e lartë shqiptarë me një axhendë të përgatitur lobimi në kryeqytetet kryesore europiane, sidomos në vendet që kishin qenë skeptike në dhjetorin e 2013-ës. Meqenëse Greqia kishte shprehur mbështetjen e saj për statusin e vendit kandidat për Shqipërinë edhe më parë, Kryesia Greke e Këshillit të BE-së në këtë mënyrë do të shërbente për të përmirësuar edhe më shumë klimën e mirë, që zyrtarët shqiptarë shpresonin të arrinin në favor të çështjes së tyre kombëtare. Në të vërtetë kjo ndodhi, dhe Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat më 24 qershor 2014. Kjo ngjarje është përmendur si ndër arritjet e Presidencës Greke të Këshillit të BE-së.⁸

Përveç faktit të dhënies së statusit të vendit kandidat, marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë po njihnin ndërkohë një vrull të ri me vizita intensive të nivelit të lartë midis Tiranës dhe Athinës, që datonin që nga viti i kaluar. Ka pasur disa çështje të rëndësishme dypalëshe që duheshin zgjidhur, të tilla

8. Gr2014eu, *Results of the Hellenic Presidency of the Council of the European Union 1 January – 30 June 2014*. Online: <http://www.gr2014.eu/home?page=1>.

si: caktimi i kufijve detarë dhe përpjekjet e reja në gjetjen e një zgjidhjeje pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë që nga prill 2009, që e cilësoi si jo-kushtetuese marrëveshjen e arritur më parë për kufijtë greko-shqiptarë të shelfit kontinental dhe zonave detare;⁹ ruajtja e varrezave përkujtimore të ushtarëve grekë të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri; gjendja e emigrantëve shqiptarë në Greqi; Ligji i luftës në Greqi; çështjen e kohëve të fundit mbi pamundësinë për të udhëtuar në Greqi të shqiptarëve të lindur në Greqi, pasi toponimet e vendlindjeve në pasaportat e tyre shqiptare ishin shkruar në gjuhën shqipe;¹⁰ etj.

Si pasojë e çështjeve dypalëshe dhe atyre të lidhura me BE-në që u përmendën më lart, zyrtarët e lartë të Greqisë dhe Shqipërisë ndërmorën një seri vizitash intensive përgjatë janarit dhe shkurtit 2014. Vizita e parë për 2014-ën u krye në Athinë në 14-15 janar 2015 nga Ministria shqiptare e Mbrojtjes Mimi Kodheli, pas një ftese nga homologu i saj grek, Dimitris Avramopoulos. Përveç takimit me Ministrin grek të Mbrojtjes, Avramopoulos, ku më së shumti u diskutuan çështje teknike në fushën e mbrojtjes, Kodheli gjithashtu u takua me Kryeministrin e Greqisë, Antonis Samaras dhe Presidentin Karolos Papulias.¹¹

Vizita e dytë u zhvillua më 5 shkurt 2015, kur Ministri shqiptar i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati vizitoi Athinën në kuadër të takimit të 16-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të nismës Adriatiko-Joniane dhe gjithashtu në konferencën strategjike të Adriatikut dhe Rajonit Jonian (EUSAIR). Bushati u takua me Presidentin grek Karolos Papulias, Kryeministrin Antonis Samaras dhe homologun e i tij, Evangelos Venizelos. Përveç çështjeve rajonale, Bushati foli edhe për shqetësimet dypalëshe me Athinën, duke përfshirë kufirin e përbashkët detar dhe emigrantët shqiptarë.¹²

9. International Boundary Research Unit (IBRU). (2010). Albanian constitutional court nullifies maritime boundary agreement with Greece. *Durham University*. Online: https://www.dur.ac.uk/ibru/news/boundary_news/?itemno=9534&rehref=%2Fibru%2Fnews%2F&resubj=Boundary+news%20Headlines.

10. Kjo çështje fundit do të shpjegohet në detaj në rastin e tretë studimor.


11. Ministria e Mbrojtjes, *Ministria e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Greqi, 14-15 janar 2014*. Online: <http://www.mod.gov.al/index.php/aktivitete-analize-2/127-ministria-e-mbrojtjes-kodheli-vizite-zyrtare-ne-greqi-14-15-janar-2014>.

12. Ministria e Punëve të Jashtme, *Ministri Bushati niset për në Athinë në kuadër të*

Vizita e fundit e kësaj serie takimesh është kryer më 20-21 shkurt nga Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Evangelos Venizelos në Tiranë¹³ si pjesë e turit të tij ballkanik, në kuadër të Presidencës Greke të Këshillit të BE-së. Përveç takimit kryesor me homologun e tij shqiptar, Bushati, ku u diskutuan çështjet dypalëshe dhe ato të lidhura me BE-në, Venizelos u takua gjithashtu me Kryeministrin shqiptar, Edi Rama, Presidentin Bujar Nishani dhe Kryetarin e Kuvendit Ilir Meta.

Të dhënat sasiore mbi mbulimin mediatik

Vëmendja e medias ndaj vizitave dypalëshe shqiptaro-greke dhe Presidencës Greke të Këshillit të BE-së në aspektin e sasisë së artikujve ishte si vijon: Shqip botoi 21 artikuj, Panorama 11 artikuj, Mapo 8 artikuj dhe Tirana Times botoi 4 artikuj (Grafiku 10).



Grafiku 10


Siç u përmend në seksionin e mëparshëm, janari dhe shkurti shënuan një nga majat e mbulimit mediatik të artikujve që lidhen me marrëdhëniet shqiptaro-greke dhe kjo si rezultat i përqendrimit të mediave në këtë tematikë. Grafiku 11 tregon se gjatë janarit (me 18 artikuj) dhe shkurtit (me 19 artikuj) mediat

Ministerialit të NAJ, (February 04, 2014). Online: <http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/ministri-bushati-niset-per-ne-athine-ne-kuader-te-ministerialit-te-naj?page=10>.

13. Duhet pasur parasysh që Venizelos vizitoi Shqipërinë edhe në tetor 2013, përpara kësaj radhe vizitash.

janë fokusuar intensivisht në vizitat dypalëshe, ndërsa në mars, maj dhe qershor i është kushtuar më pak vëmendje këtyre çështjeve edhe pse ka pasur disa artikuj mbi statusin e vendit kandidat dhe Presidencës Greke të Këshillit të BE-së në periudhën kur vendimi për statusin po afrohej.


Është interesante dhe e rëndësishme të konstatohet se në prill asnjë artikull i vetëm mbi këtë temë nuk është publikuar në mediat e studiuara. Siç do të tregojë edhe rasti i dytë studimor, media në atë kohë ishte duke u fokusuar në një temë tjetër të “nxehtë”, rastin Kareli, për të cilin opinioni publik shqiptar ishte shumë më i ndjeshëm, ndaj dhe nuk u la asnjë hapësirë për mbulimin e zhvillimeve pozitive në marrëdhëniet shqiptaro-greke.



Grafiku 11

Konotacioni

Si u pasqyrua Presidenca Greke e Këshillit të BE dhe vizitat pasuese bilaterale të nivelit të lartë midis dy vendeve në shtypin shqiptar dhe cilat ishin temat kryesore që e shoqëruan këtë mbulim mediatic? Nga grafiku 12 është e qartë se thuhet gjysma e artikujve mbi këtë temë kishin një konotacion pozitiv dhe 38 përqind e tyre raportuan në mënyrë neutrale mbi këtë çështje. Vetëm 16 përqind e artikujve diskutuan ose raportuan këtë çështje me një konotacion negativ ose quasi-negativ.



Grafiku 12

Gjuha pozitive që ka shoqëruar mbulimin e kësaj teme, është përqendruar në tre aspekte kryesore: *zgjidhja e problemeve të dyanshme, një kapitull i ri në marrëdhëniet shqiptaro-greke dhe potenciali i partneritetit*. Në të gjithë artikujt mbi takimet në Tiranë dhe Athinë, fjalët dhe frazat më të përdorura për të përshkruar rezultatet e takimit ishin: shpirti pozitiv, zgjidhja përfundimtare, bashkëpunimi i dyanshëm, partneri strategjik, mbështetja për statusin, hapja e një kapitulli të ri, kombe miqësore, atmosferë e ngrohtë dhe besim. Kjo eufori e përgjithshme ishte e dukshme edhe nga titujt dhe editorialet të tilla si: “Samaras mirëpret Bushatin: Një atmosferë besimi për çështjet e hapura”, “Greqia premtim lobim për statusin”, “Venizelos: Toponimet, një zgjidhje përfundimtare” dhe “Greqia: Statusi i vendit kandidat për Shqipërinë brenda presidencës sonë”. Për më tepër, hapësira e dedikuar këtyre artikujve ishte e gjerë, dhe disa prej tyre u shfaqën dhe në faqet e para të gazetave.

Raportimi neutral pati tone më të moderuara, duke balancuar entuziazmin mbi zhvillimet e reja në çështjet bilaterale që të dy vendet ende duhet të zgjidhin. Kjo gjuhë balancuese ishte e dukshme edhe në titujt dhe editorialet si: “Greqia ofron statusin por kërkon varrezat e ushtarëve”, “Marrëveshja e 2009-ës, Venizelos: pas negociatave ne shpresojmë se do të hyjë në fuqi” dhe “Bushati: Pakti Detar sipas ligjit ndërkombëtar”. Pjesë të këtij raportimi

neutral ishin edhe intervistat e Bushatit, Venizelosit dhe Niko Peleshit, Zëvendësministrit të Jashtëm shqiptar, gjuha e të cilëve ishte e moderuar, diplomatike, dhe politikisht korrekte, sidomos kur u referohej çështjeve që janë ende të hapura midis dy vendeve.

Megjithëse artikujt me konotacion negativ ose quasi-negativ ishin në minorancë, është me vlerë të hidhet një vështrim mbi temat kryesore që ato kanë mbuluar, të tilla si: Greqia ofron ndihmë vetëm për të marrë diçka në këmbim dhe ka çështje të pazgjidhura, të cilat janë lënë qëllimisht jashtë negociatave. Titujt e këtyre artikujve gjithashtu shfaqin këtë tension: “Toponimet: Bushati dështon në negociatat me Venizelosin”, “Kujdes ndaj dhuratave greke”, “Kufijtë detarë: Greqia këmbëngul në paktin antikushketues” dhe “E pafalshme që Çamëria nuk u përmend”. Kështu, si zyrtarët grekë ashtu edhe ata shqiptarë janë portretizuar negativisht në këto artikuj, por ndërsa zyrtarët shqiptarë janë portretizuar si të paaftë për të zgjidhur apo përmendur çështjet, ata grekë konsiderohen se janë duke punuar me një axhendë të fshehtë të paracaktuar.

2. Historia e hidhur: Rasti Kareli

Ngjarja

Ilia Kareli, gjithashtu i njohur si Kudret Kume (emri i tij shqiptar), ishte një i burgosur shqiptar në Greqi i cili u gjet i vdekur në qelinë e tij, pas torturave të shkaktuara nga rojet e burgut, në burgun e Nigritas ku ai ishte transferuar pasi vrau një roje burgu në burgun e Malandrinos. Ngjarjet filluan në fund të marsit 2014, në burgun e Malandrinos, ku Kareli, një i burgosur i këtij burgu, goditi me thikë Giorgos Tsironis, një gardian burgu. Ai deklaroi se e kreu këtë akt pas refuzimeve të vazhdueshme nga zyrtarët e burgut për t'i dhënë atij leje për të vizituar nënën e tij të sëmurë. Kareli u transferua menjëherë në burgun e Nigritas për arsye sigurie, ku ai u gjet i vdekur në të njëjtën ditë nga ato që u konfirmuan më vonë si tortura.

Një hetim u hap menjëherë pas ngjarjeve dhe mediat greke ishin të parat që monitoruan nga afër rastin. Mediat transmetuan fotot dhe videot e Karelit në burgun e Nigritas ndërsa ai ishte duke u shoqëruar në qelinë e tij në një gjendje shumë të rëndë. Këto foto dhe video gjithashtu u shpërndanë gjerësisht në mediat shqiptare.

Në fillim të prillit, pas autopsisë dhe hetimeve të mëtejshme, 13 gardianë të burgut u dërguan në gjyq për t'u përballur me akuzat për tortura që shkaktuan vdekjen. Mes tyre ishte edhe kreu i sindikatës së gardianëve të burgut, Haris Konsolidis. Sipas portalit Greek Reporter, vendimi i gjykatës 189/2014, deklaroi se:


“I burgosuri shqiptar Ilia Kareli, i cili në 25 mars 2014 plagosi për vdekje gardianin e burgut të Malandrinos, Giorgos Tsironis, u transferua në 27 mars 2014, nga Qendra e Paraburgimit të Përgjithshëm të Malandrinos në Qendrën e Paraburgimit të Nigritas. Me mbërritjen e tij në burgun e Nigritas dhe gjatë kohës së qëndrimit të tij në zonën e pritjes nga ora 15:55 deri 18:32, kur ai u dërgua në qelinë e tij, gardianët e burgut të Nigritas torturuan të burgosurin në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme për ta ndëshkuar atë për vdekjen e

kolegut të tyre. Veprimet e gardianëve i shkaktuan të burgosurit shqiptar djegie dhe frakturë në kafazin e krahavorit. Fraktura dhe aktet sistematike të torturës, ishin të mjaftueshme për të shkaktuar vdekjen e Ilia Karelit si pasojë e aritmisë kardiake disa orë më vonë.”¹⁴

Trupi pajetë i Ilia Karelit iu dorëzua më pas autoriteteve shqiptare, pas kërkesës së tyre për të kryer një autopsi. Në fund, Kareli u varros në vendlindjen e tij në Fier, Shqipëri.

Të dhënat sasiore mbi mbulimin mediatik


Rasti Kareli ishte historia më e mbuluar gjatë periudhës shtatë mujore të monitorimit nga ky studim. Numri i artikujve sipas gazetave është: Shqip ka 25 artikuj, Panorama dhe Mapo kanë nga 19 artikuj secila dhe Tirana Times, ka 3 artikuj mbi rastin.



Grafiku 13

Gjatë muajve mars dhe prill, mediat shqiptare u fokusuan gjerësisht në rastin Kareli. Nga monitorimi i mediave të shkruara për këtë studim, 12 artikuj janë botuar në mars dhe 47 artikuj u botuan në prill, ndërsa artikujt e pakët në maj, qershor dhe korrik (7 gjithsej) ishin kryesisht të përqendruar në raportimin e vendimeve gjyqësore në Greqi.


14. Dafne Tsagari, Thirteen Prison Guards Tried For the Death of Albanian Inmate. *Greek Reporter* (October 23, 2014). Online: <http://greece.greekreporter.com/2014/10/23/thirteen-prison-guards-tried-for-the-death-of-albanian-inmate/>.



Grafiku 14

Konotacioni

Si raportuan mediat shqiptare mbi rastin e mbuluar gjerësisht dhe hollësisht të Ilia Karelit dhe cilat ishin tematikat që shoqëruan këtë mbulim? Nuk është surprizë që rasti u mbulua gjerësisht në një mënyrë negative nga mediat shqiptare, duke e bërë zbulimin e variacionit në konotacion shumë të vështirë. Megjithatë, edhe pse mbulimi i përgjithshëm i situatës u krye përmes toneve negative (68 përqind e artikujve), thuajse çereku i artikujve (24 përqind) kishin një konotacion quasi-negativ, dhe 8 përqind një konotacion neutral. Kështu, 1/3-ta e kampionit e mbuloi çështjen në një mënyrë më të moderuar krahasuar me shumicën. Nuk ka pasur asnjë artikull me konotacion pozitiv.



Grafiku 15

Kur analizojmë gjuhën e përdorur për të mbuluar çështjen Kareli, është e vështirë të konstatojmë një portretizim të qëllimshëm negativ të situatës, në kuadër të një përshkrimi ku do të përdoren pashmangshmërisht fjalë dhe fraza të tilla si: vdekje, torturë, rrahje, burg, vrasja e një të burgosuri shqiptar, etj. Kështu, konotacioni i rrëfimit është i paracaktuar nga rrethanat në një shkallë të konsiderueshme. Megjithatë, është e rëndësishme të shihet se çfarë dhe si është raportuar në mediat shqiptare, që shkon përtej pasqyrimit të fakteve të ngjarjes.

Në grupin më të madh të artikujve të klasifikuar me konotacion negativ ose quasi-negativ, ka tre tema madhore që përcaktuan konotacionin e tyre:

(1) *Raportimi i rastit duke u bazuar në efektin horror*: që do të thotë një raportim shumë i detajuar i plagëve, teknikave të torturës dhe asaj çfarë mund të quhet si: ‘çastet e fundit të jetës së Karelit’, të shoqëruar nga fotografi që në disa rrethana edhe mund të ishin censuruar. Këta artikuj kishin më shumë tendencën e përhapjes së efektit të shokut sesa të raportimit të çështjes. Shumë nga artikujt mbulonin dy faqe të tëra me fotografi të mëdha. Editoriale tipike për këtë kategori janë: “Autopsia zbardhë torturat: 15 plagë në trupin e Kumes, thyerje kafke dhe heqje thonjsh”, “Shqiptari u torturua për 3 orë në dhomën ‘frigorifer’”, “Masakra ndaj Karelit, dalin foto të tjera të torturës” dhe “E vunë në karrige elektrike, i kanë nxjerrë njërën sy dhe i kanë shtypur kraharorin”. Spekulumet ishin gjithashtu të pranishme në disa artikuj dhe u raportuan si fakte.

(2) *Raportimi i çështjes duke u mbështetur në një efekt emocional dhe ‘kombëtar’*. Kjo temë ishte gjithashtu shumë e pranishme në të gjithë artikujt mbi Karelin dhe ajo përfshiu kryesisht raporte nga ana ‘shqiptare’ e ngjarjes, pra duke synuar një viktimizim të gjerë kombëtar. Këta artikuj u fokusuan kryesisht tek familja e tij, nëna e tij, sesi atij ju mohua leja për të vizituar atë si dhe njerëzit e shumtë në funeral, flamujt kombëtarë, etj. Këta artikuj kanë cituar shpesh herë nënën e tij dhe janë përpjekur t’i japin një dimension emocional çështjes duke portretizuar Karelin si një ndër shumë viktimat në radhët e emigrantëve shqiptarë në Greqi.

Ky 'nacionalizim' i rastit Kareli si rasti i fundit i një fenomeni më të gjerë, sidomos kur bëhet fjalë për Greqinë, ishte më i pranishëm në artikujt që raportuan mbi funeralin e tij apo për praninë e madhe të njerëzve dhe flamujve kombëtarë në varrimin e Karelit. Ky element i fundit është shumë interesant sepse dëshmon për një lloj procesi heroizimi në të bërit e Ilia Karelit qendër të një kauze më të gjerë duke vënë në pah shqiptarizmin e tij. Disa tituj të zakonshëm të kësaj kategorie të artikujve me konotacion negativ ishin: "Kume përcillet me dhjetëra flamuj kuqezi", "S'mori leje për të vizituar nënën, vret gardianin grek", "Djalë 8 vjet pa e parë, nuk më linin ta takoja në burg" dhe "Nëna e shqiptarit të vrarë në burgjet greke: Nuk më lejuan ta takoja tim bir".

(3) *Raportimi i çështjes duke theksuar përgjegjësinë e shtetit dhe të institucioneve greke.* Kjo kategori e artikujve ishte e përbërë kryesisht nga editorialet, opinionet dhe intervistat (këto u raportuan kryesisht nëpërmjet një konotacioni quasi-negativ). Toni i përgjithshëm ishte më i ftohtë në krahasim me kategoritë e mëparshme dhe në këto raste u aplikua një logjikë më racionale. Këta artikuj përgjithësisht konsideronin shtetin dhe institucionet greke si përgjegjës për ngjarjen dhe disa theksonin faktin që ata i konsideronin ngjarjet aktuale vetëm si pjesë e tendencës së përgjithshme të mënyrës sesi emigrantët, veçanërisht emigrantët shqiptarë, trajtohen dhe janë trajtuar në Greqi. Kjo kategori artikujsh përfshinin tituj të tillë si: "Shteti grek është një shartim i neonazizmit me talebanizmin", "Ilia Kareli u vra nga institucioni grek, e jo thjesht nga individë!" dhe "Vrasja e Karelit, një fund i paralajmëruar para 17 vitesh".

Në anën tjetër, artikujt neutralë, megjithëse një minoritet i vogël prej 8 përqind, ishin më të kujdesshëm në parashtrimin e fakteve dhe lënie jashtë të qëndrimeve të tjera. Mbulimi ishte më i shkurtër dhe i balancuar midis raportimit të ngjarjeve që sollën vdekjen e Karelit dhe masave të ndërmarra nga Greqia për hetimin e rastit dhe dënimin e personave përgjegjës. Një shembull i titullit të kësaj kategorie artikujsh është: "Shefi i burgut grek: Unë e torturova Ilia Karelin".

3. Historia e përzier: Çështja e toponimeve

Ngjarja

Më 12 maj 2014, Ministrat grekë dhe shqiptarë të Punëve të Jashtme, Evangelos Venizelos dhe Ditmir Bushati, arritën një marrëveshje mbi përdorimin e emrave gjeografikë (toponimeve) të Greqisë në dokumentet e Shqipërisë. Marrëveshja u nënshkrua në Bruksel, edhe pse negociatat vazhduan për disa muaj dhe marrëveshja u diskutua më parë në Selanik më 8 maj. Marrëveshja, ashtu si problemi paraardhës që çoi në nënshkrimin e saj, është konsideruar vazhdimisht si çështje teknike, por njëherësh shumë e rëndësishme nga të dyja palët.


Situata që u zgjidh me këtë marrëveshje ishte si vijon: Në pasaportat shqiptare të emigrantëve shqiptarë të lindur në Greqi, emri i vendlindjes së tyre ishte shkruar në gjuhën shqipe në vend të gjuhës angleze. Për shembull, ishte shkruar Selanik, Athinë, Kostur, në vend të Thessaloniki, Athens, Kastoria. Kjo situatë u bë problematike sidomos pas vitit 2011, kur për qytetarët shqiptarë u lëshuan pasaportat e reja biometrike, pas vendosjes së regjimit të lirë të vizave me vendet e zonës Shengen. Fillimisht, konsullatat greke në Shqipëri filluan të refuzojnë nënshkrimin e certifikatave të lindjes së fëmijëve shqiptarë të lindur në Greqi, për të vijuar më tej me ndalimin e kalimit të kufirit grek dhe refuzimin e rinovimit të lejeve të qëndrimit në Greqi. Situata u tensionua sidomos në fund të viti 2012 dhe gjatë gjithë 2013-ës duke pasur parasysh edhe faktin se qytetarët në fjalë ishin kryesisht fëmijë apo të rinj, pasardhës të emigrantëve shqiptarë, që kanë lindur në Greqi pas viteve '90 dhe që vijnë të jetojnë dhe punojnë në këtë vend.

Marrëveshja konsistonte në lëshimin nga ana e autoriteteve shqiptare të pasaportave të reja për shqiptarët e lindur në Greqi, ku emri dhe vendlindja do të jenë në gjuhën angleze, duke ndjekur standardet e "emërtimeve gjeografike të depozituara nga të gjitha vendet anëtare të OKB-së, dhe gjithashtu standardet e ICAO-s (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit

Civil)¹⁵. Me rastin e festës së Pashkëve 2014, autoritetet greke hartuan një memorandum për të lejuar këta qytetarë të hyjnë/dalin nga Greqia me pasaportat e tyre aktuale dhe marrëveshja ia zgjati vlefshmërinë këtij memorandum deri në janar të viti 2015, afati i përcaktuar për t'u pajisur me pasaporta të reja nga ana e këtyre qytetarëve.

Të dhënat sasiore mbi mbulimin mediatik

Duhet theksuar se çështja e toponimeve ka zgjatur disa vjet dhe se ky studim monitoron vetëm mbulimin mediatik të ngjarjeve të ndodhura nga janari 2014 deri në korrik 2014. Gjatë kësaj periudhe, çështja e toponimeve ishte më së shumti e mbuluar nga Shqip me 19 artikuj, e ndjekur nga Panorama me 7 artikuj, dhe Mapo e Tirana Times me tre artikuj në total.




Grafiku 16

Duke pasur parasysh faktin që çështja e toponimeve ka qenë një çështje që ka zgjatur në kohë dhe nuk ka ndodhur në një moment të caktuar për t'u klasifikuar si çështje e "nxehtë", shpërndarja mujore e artikujve në lidhje me këtë temë ka qenë mjaft e gjerë. Kështu, tema është mbuluar në mënyrë të konsiderueshme në janar dhe shkurt (me 13 artikuj në total), si pjesë çështjes që ka të bëjë me vizitat dypalëshe të zyrtarëve dhe gjithashtu është mbuluar

15. Ministria e Punëve të Jashtme, *Zgjidhet çështja e toponimeve: Deklarata e Ministrit të Jashtëm lidhur me çështjen e toponimeve*. (May 15, 2014). Online: <http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/zgjidhet-ceshtja-e-toponimeve&page=4>.


gjerësisht në maj (11 artikuj) me nënshkrimin e marrëveshjes në Bruksel.



Grafiku 17

Konotacioni

Për shkak se ky studim ka monitoruar artikuj në periudhën janar-korrik 2014, duhet theksuar se gjatë kësaj kohe situata ishte më pak e tensionuar. Shumica e artikujve (45 përqind) e mbuloi situatën përmes një konotacioni neutral. Artikujt pozitivë dhe negativë kishin saktësisht të njëjtën përqindje me 24 përqind secilin. Artikujt quasi-negativë përbënin 7 përqind të kampionit.



Grafiku 18

Grupi i artikujve neutralë ishte kryesisht i fokusuar tek çështjet teknike. Ato ishin të pranishme përgjatë gjithë periudhës së mbulimit të studimit

dhe citonin gjerësisht deklarata nga zyrtarët shtetërorë, të cilët gjatë kësaj kohe ishin të moderuar. Tituj tipikë të kësaj kategorie ishin: “Toponimet: dy opsionet në negociatat me Greqinë”, “Toponimet, Spanou: Do të ndërhyjmë për të shmangur problemet në kufi” dhe “Shqipëria dhe Greqia arrijnë marrëveshje për shkrimin e vendlindjes në pasaporta”. Shumë artikuj në këtë kategori nuk ishin tituj kryesor dhe ishin të pozicionuar kryesisht në fund të faqeve të gazetave duke mos zënë shumë hapësirë.

Grupi i artikujve pozitivë kishin një ton të fortë *pajtuës* dhe theksonte faktin që kjo zgjidhje do të ishte e qëndrueshme. Në këtë kuadër, fraza të tilla si zgjidhje, zgjidhje e përhershme, pa probleme, shembull i mirë, partneritet dhe bashkëpunim ishin ndër titujt më të përdorur në këta artikuj. Këta artikuj pozitivë janë botuar kryesisht në maj, kur u arrit marrëveshja. Tituj tipikë përfshinin: “Toponimet, Bushati: Pakti ynë me Greqinë, model dhe me shtetet e tjera”, “Selanik, Bushati takon emigrantët: Toponimet pranë zgjidhjes praktike” dhe “Venizelos: Toponimeve, zgjidhje përfundimtare”.

Grupi i artikujve negativë, e analizoi dhe prezantoi këtë çështje si *politike dhe jo teknike*. Këta artikuj përgjithësisht mbulonin situatën në terren në pikat kufitare duke pasqyruar historitë personale të emigrantëve shqiptarë, që nuk mund të kalonin kufirin për shkak të toponimeve në pasaportat e tyre. Shumë komente dhe opinione trajtuan toponimet si një episod tjetër të asaj që ata e shihnin si një politikë të vazhdueshme të Greqisë kundrejt emigrantëve shqiptarë. Shumë pak artikuj me konotacion negativ ose gjysmë negativ fajësuan apo e konsideruan shtetin shqiptar si përgjegjës për situatën. Kështu, mesazhi i përgjithshëm i këtyre artikujve ishte i qartë: Faji është i Greqisë! Titujt më të përhapur të këtyre artikujve ishin: “Tavo nga Gjirokastra, toponimet: Mijëra shqiptarë po vuajnë pasojat e politikës”, “Fluks në kufi për toponimet, emigrantët: Kemi katër orë që presim” dhe “Greqia nuk rinovon lejet, shkak toponimet”.

Referencat

Armakolas, Ioannis, *The Greek Public Opinion towards Albania and the Albanians: Social attitudes and perceptions*, Hellenic Foundation for European and Foreign Policy and Friedrich Ebert Stiftung, December 2013.

Balla, Andi, Filip Ejduš & Megi Llubani, *Shqipëria dhe Serbia: A përputhen perceptimet me realitetin?*, Albanian Institute for International Studies and Belgrade Centre for Security Policy, Tirana and Belgrade, 2013.

Çela, Alba & Sashenka Lleshaj, *Marrëdhëniet Shqipëri-Greqi në sytë e publikut shqiptar: Perceptime 2013*, Albanian Institute for International Studies and Friedrich Ebert Stiftung, Tirana, March 2014.

Gr2014eu, *Results of the Hellenic Presidency of the Council of the European Union 1 January – 30 June 2014*. Online: <http://www.gr2014.eu/home?page=1>.

International Boundary Research Unit (IBRU). (2010). Albanian constitutional court nullifies maritime boundary agreement with Greece. *Durham University*. Online: https://www.dur.ac.uk/ibru/news/boundary_news/?itemno=9534&rehref=përqind2Fibru_përqind2Fnews_përqind2F&resubj=Boundary+news_përqind20Headlines.

McLuhan, Marshall, *Understanding Media: The extensions of Man*, Routledge, London, 1964.

Ministria e Mbrojtjes, *Ministrja e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Greqi, 14-15 janar 2014*. Online: <http://www.mod.gov.al/index.php/aktivitete-analize-2/127-ministrja-e-mbrojtjes-kodheli-vizite-zyrtare-ne-greqi-14-15-janar-2014>.

Ministria e Punëve të Jashtme, *Ministri Bushati niset për në Athinë në kuadër të Ministerialit të NAJ*, (February 04, 2014). Online: <http://www.punetegashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/ministri-bushati-niset-per-ne-athine-ne-kuader-te-ministerialit-te-naj?page=10>.

Ministria e Punëve të Jashtme, *Zgjidhet çështja e toponimeve: Deklarata e Ministrit të Jashtëm lidhur me çështjen e toponimeve*. (May 15, 2014). Online: <http://www.punetegashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/zgjidhet-ceshtja-e-toponimeve&page=4>.

Tsagari, Dafne, Thirteen Prison Guards Tried For the Death of Albanian Inmate. *Greek Reporter* (October 23, 2014). Online: <http://greece.greekreporter.com/2014/10/23/thirteen-prison-guards-tried-for-the-death-of-albanian-inmate/>.